



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1201 Prot.

Tiranë, më 11.05.2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 52, datë 11.05.2026

PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, neni 25, pika 7, neni 38, neni 42, pika 7, neni 69, pika 3, neni 77 dhe 78, Statutit të UMT-së neni 5, neni 12, neni 26, neni 44, neni 86, Rregullores së UMT-së, si dhe bazuar në propozimet e Fakultetit të Mjekësisë me shkresat nr. 1436/1 prot., datë 29.04.2026 dhe nr. 1436/3 prot., datë 06.05.2026 dhe të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike me shkresën nr. 458/2 prot., datë 30.04.2026, Senati Akademik i UMT-së,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në programet e ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë në “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027, janë në total 805 (tetëqind e pesë) kuota, të ndara si më poshtë:
 - a. Kuota pranimi për kandidatët brenda vendit 732;
 - b. Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit 45;
 - c. Kuota për persona me statusin e jetimit 12;
 - d. Kuota për persona me aftësi të kufizuar 3;
 - e. Kuota për Romë dhe Ballkano-Egjiptian 10;
 - f. Kuota për shtetasit e huaj 3;
2. Kuotat e pranimit për programet e studimit sipas pikës 1 të këtij vendimi pasqyrohen në mënyrë të detajuar në tabelën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e tij.
3. Kuotat e pranimit të paplotësuara sipas pikës 1 të këtij vendimi rishpërndahen nga Rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, mbi bazën e propozimeve të paraqitura nga dekanatet e njësive kryesore.
4. Çdo program studimi i ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” aktivizohet në vitin akademik 2026–2027, vetëm në rast se regjistrohen të paktën 10 (dhjetë) studentë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit, Qendrës së Shërbimeve Arsimore, si dhe njësive kryesore të UMT-së.

KRYETARI

PROF. DR. XHELADIN DRACINI



Tabela Nr. 1 Kuotat e pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë, për vitin akademik 2026-2027

FAKULTETI	PROGRAMI I STUDIMIT	TOTAL KUOTA 2026-2027	SHQIPTARË BRENDË VENDIT	Program të dytë	Transferim studimesh	Shtetas me diplomë të huaj	Me statusin e jetimit	Persona me aftësi të kufizuar	Romë + ballkano egjiptian	Kosovë	Maqedoni e Veriut	Mali i zi	Preshevë	Bujanovc	Medvegjë	Total troje
F. i Mjekësisë	Master i Shkencave në Shëndet Publik	25	25													
F. i Mjekësisë	Master Profesional në Shëndet Publik	25	25													
F. i Mjekësisë	Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor	30	30													
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave në Infermier	185	175	0	0	1	1	1	2	1	1	1	1	1	0	5
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave në Mami	35	30	0	0	0	1	0	0	1	1	1	1	0	0	4
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave në Fizioterapi	60	51	0	0	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	5
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave në Teknikë Imazherie	60	55	0	0	0	1	0	0	1	1	1	1	0	0	4
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave në Teknikë Laboratori	60	55	0	0	0	1	0	0	1	1	1	1	0	0	4
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master i Shkencave në Logopedi	35	30	0	0	0	1	0	1	1	0	1	1	0	0	3
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional në Menaxhim Infermieror	90	81	0	0	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	5
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional në Mami	30	25	0	0	0	1	0	1	1	0	1	1	0	0	3
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional në Fizioterapi	50	45	0	0	0	1	0	1	1	0	1	1	0	0	3
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional në Teknikë Imazherie	30	25	0	0	0	1	0	1	1	0	1	1	0	0	3
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional në Teknikë Laboratori	30	25	0	0	0	1	0	1	1	0	1	1	0	0	3
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional në Logopedi	30	25	0	0	0	1	0	1	1	0	1	1	0	0	3
F. i Shkencave Mjekësore Teknike	Master Profesional në Infermier Famiije	30	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	TOTAL	805	732	0	0	3	12	3	10	12	6	12	12	3	0	45